VENDIM
Nr. 58, datë 7.10.2020

PËR PËRJASHTIMIN NGA MBAJTJA E KOMISIONEVE PËR LLOGARITË E HAPURA NË SISTEMET E PAGESAVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 73, të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë"; si dhe nenit 50, pika 3, të rregullores nr. 76, datë 18.12.2014, "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)", të ndryshuar; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Përjashtimin nga mbajtja e të gjitha komisioneve për të gjitha llogaritë e hapura në sistemet e pagesave AFISaR të Bankës së Shqipërisë, për administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko